1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME TEKNIKE

PËR AUTOMJET ZJARRFIKËS ME TANKER UJI DHE POMPË

VITI I PRODHIMIT: MINIMUNI 2006 OSE MË I RI

KILOMETRA TE PERSHKRUARA JO ME SHUME SE 40 000 KM

1. OBJEKTI

Objekti i këtij specifikimi teknik është përcaktimi i kërkesave minimale teknike, funksionale dhe operative për furnizimin me automjet zjarrfikës me tanker uji dhe pompë zjarrfikëse, të përshtatshëm për operacione urbane dhe rurale të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.

Automjeti duhet të jetë në gjendje operative, funksionale dhe i përshtatshëm për përdorim intensiv nga shërbimi zjarrfikës.

2. BAZA LIGJORE

Ky specifikim teknik hartohet në mbështetje të:

- Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
 - Nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”;
 - Legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimit;
 - Standardeve europiane EN 1846 dhe EN 1028;
 - Akteve nënligjore në fuqi për prokurimin publik.
-

3. EKUIVALENCA TEKNIKE

Në përputhje me nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, çdo referencë në këtë specifikim ndaj:

- standardeve;
- markave;
- origjinës;
- prodhuesve;
- patentave;
- tipologjive;
- ose proceseve specifike të prodhimit,

Autoriteti kontraktor pranon çdo zgjidhje ekuivalente ose superiore, për sa kohë operatori ekonomik provon me dokumentacion teknik dhe certifikime përkatëse se:

- përmbushen parametrat minimalë teknikë;
 - garantohet i njëjti funksion operacional;
 - sigurohet i njëjti nivel sigurie dhe performance;
 - respektohen standardet europiane ose ndërkombëtare të aplikueshme.
-

4. STANDARDET DHE CERTIFIKIMET

Automjeti dhe pajisjet duhet të jenë në përputhje me:

- EN 1846 – Fire Fighting Vehicles;
- EN 1028 – Fire Fighting Pumps;

- DIN 14530;
- ISO 9001;
- ISO 14001;
- Certifikim CE.

Pranohen edhe standarde ekuivalente sipas nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020.

5. SHASIA DHE STRUKTURA MBAJTËSE

5.1 Konfigurimi

Parametri	Kërkesa Minimale
Tipi	Automjet zjarrfikës me tanker dhe pompë
Konfigurimi	4x2
Pesha totale	Jo me e madhe 13500 kg
Kabina	Dopio kabinë fabrike
Kapacitet ekuipazhi	Minimumi 1+1+2+4 persona
Gjatesia e mjetit	Jo me shume se 7000 mm
Superstruktura e mjetit	Alumin I perforcuar
Baraban me presion te larte	Ne dz anet e mjetit me mbyllje elektrike dhe manuale 2x 60 ml
Tarraca e mjetit	Alumin I perforcuar
Shkalle ndihmese	Ne dy anet e mjetit per ngjitje ne tarrace
Shkalle portable 10m	Alumin I perforcuar me sistem hidraulik ulje
Shkalle ndihmese	Per kabinen e dyte qe mundeson daljen hidraulike me rreshitje ne momentin e hapjes se deres duke lehtesuar ngjitjen e ekuipazhit ne mjet me shpejt
Gomat e mjetit	Te reja
Rrezja e diskut	Jo me e madhe se 19,5
Ndricues qendror	Pneumatik me me zgjatje per ndricim naten gjate punes
Ndricimi sinjalistik alarmues	Ngjyre blu ne te 4 anet funksional
Xhamat	Mbyllje elektrike
Pasqyrat ndihmese	5 cope
Kamera	Ne bord

5.2 Parametrat Operacionalë

Parametri	Kërkesa
Ground clearance	Minimumi 300 mm
Pjerrësia e ngjitjes	Minimumi 30%
Këndi i afrimit	Minimumi 18°

Parametri	Kërkesa
Këndi i largimit	Minimumi 15°
Stabiliteti lateral	Sipas EN 1846 ose ekuivalente

5.3 Shasia

- Shasi heavy-duty industriale;
- Trajtim antikoroziv me primer epoxy;
- Sandblasting SA 2.5;
- Bojë industriale poliuretani;
- Trashësi totale boje minimumi 120 micron.

6. MOTORI

6.1 Karakteristikat

Parametri	Kërkesa
Tipi	Diesel Turbo Intercooler
Standard ekologjik	Minimumi Euro 3 ose ekuivalente
Fuqia Kapaciteti I motorrit	Minimumi 250 HP Jo me shume se 6374 CC
Çifti rrotullues	Minimumi 1200 Nm
Sistemi i injeksionit	Common Rail elektronik

6.2 Sistemet Ndhmëse

- Ftohje me ujë;
- Filtra heavy-duty;
- Alternator minimumi 120 A;
- Bateri 2 x 12V heavy duty.

7. TRANSMETIMI

- Kambio manuale ZF ose ekuivalente;
- Minimumi 6 marshe përpara + 1 mbrapa;
- PTO për aktivizimin e pompës;
- Diferencial me bllokim;
- Reduktor për terrene të vështira (nëse është 4x4).

8. SISTEMI I FRENIMIT

8.1 Frenimi Kryesor

- Sistem pneumatik dual-circuit;
 - ABS;
 - ASR;
 - ESP.
-

8.2 Frenimi Ndhmës

- Frenë motorike;
 - Retarder hidraulik ose elektromagnetik:
 - Voith;
 - Telma;
 - ZF Intarder;
 - ose ekuivalente.
-

8.3 Frenimi i Parkimit

- Aktivizim pneumatik automatik.
-

9. SUSPENSIONI

- Suspension heavy-duty;
 - Parabolik ose air suspension;
 - Stabilizator transversal;
 - Amortizatorë hidraulikë industrialë.
-

10. TANKERI I UJIT

10.1 Kapaciteti

Parametri	Kërkesa
Kapacitet ujë	Jo me pak se 2500 litra
Rezervuar shkumë	Minimumi 200 litra

10.2 Materiali

Rezervuari duhet të jetë:

- Inox AISI 304/316; ose
- Polipropilen HDPE antikoroziv ose ekuivalente.

10.3 Trashësia

Elementi Trashësia Minimale

Mure anësore 4 mm

Fundi 5 mm

10.4 Ndërtimi

- Ndarje anti-valëzim;
 - Strukturë vetëmbajtëse;
 - Rezistent ndaj korrozionit dhe shkumës zjarrfikëse;
 - Sistem kullimi kundër ngricës.
-

10.5 Pajisjet

- Kapak inspektimi Ø450 mm;
 - Tregues niveli elektronik;
 - Tub mbushës DN100;
 - Valvul shkarkimi.
-

11. POMPA ZJARRFIKËSE

11.1 Standardi

Pompa duhet të jetë sipas:

- EN 1028; ose
 - ekuivalente.
-

11.2 Tipi NH30

- Pompë centrifugale me një ose dy faza min. AT2/TLF 2000
 - Montim fiks në automjet.
-

11.3 Performanca

Minimumi:

- FPN 10-2000
- FPN 10-3000.

11.4 Parametrat

Parametri	Kërkesa
Debiti	2000–3000 l/min në 10 bar
Presioni maksimal	Minimumi 16 bar
Presioni minimal	Minimum 10 bar
Rrotullime/min	Jo me pak se 3850 rpm/min
Paneli I pompes	Dixhital

E preferueshme :

E gjithë pompa e jshtme duhet të jetë e veshur me material kundër demtimit dhe të reduktojë zhurmen për një mënyrë sa më të qartë dhe normale komunikimi gjatë përdorimit të saj

11.5 Sistemi i Primimit

- Primim automatik vakumi
 - Koha e primimit maksimumi 30 sekonda në 6 m.
-

11.6 Materiali

Elementi	Materiali
----------	-----------

Trupi i pompës	Aliazh alumini antikoroziv ose bronz special
Impeleri	Bronz/Inox

11.7 Kontrolli

- Electronic Pump Governor;
 - Automatic Pressure Control;
 - Dry-run protection;
 - Overheat protection.
-

12. SISTEMI HIDRAULIK

12.1 Tubacionet

- Inox ose galvanizuar

-
- PN16 minimumi.
-

12.2 Bashkuesit

- STORZ alumin/inox ose ekuivalente.
-

12.3 Daljet Hidraulike

Automjeti duhet të jetë i pajisur minimalisht me:

- 2 x dalje presioni B75
 - 1 x dalje A110
 - 1 x dalje high pressure (nëse aplikohet)
 - 1 x dalje për mbushje të shpejtë tankeri
 - dalje me bashkues tip STORZ ose ekuivalente
 - valvula kontrolli individuale për secilën dalje
-

12.4 Hyrjet

- DN110 STORZ.
-

12.5 Valvulat

- Bronzi ose inox industrial.
-

113. SUPERESTRUKTURA

13.1 Materiali

- Alumin industrial antikoroziv; ose
 - inox.
-

13.2 Ndërtimi

- Strukturë modulare
- Subframe elastik anti-torsion
- Silent blocks anti-vibrim
- Fiksime inox.

13.3 Kompartimentet

- Dyer roletë alumini
- DysHEME anti-slip
- Ndriçim LED IP65.

14. SISTEMI ELEKTRIK

- Sistem 24V
- CAN-BUS system
- Shore line charging system
- Battery charger automatik
- Drita LED emergjence
- Sirenë elektronike 100–120 dB
- Projektore LED pune.

15. MBROJTJA ANTIKOROZIVE

- Primer epoxy
- Bojë poliuretani industriale
- Vida dhe bulona inox
- Rezistencë ndaj lagështisë dhe kripës.

16. PAJISJE OPERATIVE PËR SHPËTIM TEKNIK DHE RASTE SPECIALE

Automjeti duhet të jetë i pajisur me pajisje profesionale për ndërhyrje në aksidente rrugore, shpëtim teknik, ngritje strukturash dhe menaxhim të situatave emergjente komplekse.

17.1 Pajisje mekanike dhe manuale shpëtimi

- Automjeti duhet të ketë minimalisht:
- levë shpëtimi (crowbar);
- çekan shpëtimi;
- çekiç i rëndë
- kazmë
- lopatë
- set çelësash mekanikë
- kablllo tërheqëse

17.2 Sopatë zjarrfikëse profesionale

Sopatë zjarrfikëse e certifikuar për përdorim operacional;

Kokë çeliku e trajtuar termikisht, dorezë ergonomike me izolim elektrik, rezistente ndaj goditjeve dhe temperaturave të larta.

17.3 Pinca dhe mjete të izoluara për energji elektrike

Për ndërhyrje në automjete elektrike ose ambiente me rrezik elektrik, automjeti duhet të ketë:

- Pinca të izoluara për prerje kabllosh energjie

- Gërshërë teknike të izoluara
- Doreza dielektrike;
- Të gjitha pajisjet duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve të sigurisë elektrike ose ekuivalente.

17.4 Kërkesa të përgjithshme

Të gjitha pajisjet duhet të jenë:

Të montuara dhe të fiksuara në kompartimentet e automjetit; lehtësisht të aksesueshme gjatë operimit të shoqëruara me manual përdorimime certifikata konformitetin e gjendje të plotë funksionale.

17.5 Pompe portative zhytëse/thithëse cope 2

Tensioni 230v

Frekuenca 50Hz

Monofaze

Fuqia jo me pak se 900W

Rryne 5.2 Amp.

Lartësia maksimale jo me pak se 12 m

Prurja jo me pak se 5 lt) sek.

Mbrojtje Ip 68 rezistente ndaj ujit

17.6 Ventilator Industrial cope 2

Fuqia 1.5 k/f

Tensioni 230 V

Shpejtësia 3450 rpm

Rezistente për temperatura ambientale deri në 40 grade

Mbrojtja ip 54

Niveli i zhurmës maksimumi 98 Db

Të jetë i pajisur, e mbrojtje termike automatike si dhe i përshtatshëm për ambiente me rrezik të lartë gaz, zjarri, shperthimi

17.7 Gjenerator portativ cope 2

Fuqia jo me pak se 3.4 kw

Ekuivalenca 2700w

Tensioni 230V

Rryma 11.6 Amp

Frekuenca 50 Hz

Pesha maksimale jo me shumë se 50 kg

17.8 Monitor portativ cope 1

Monitor portativ tokë stacionar zjarrfikës i nevojshëm për ujë/shkumë

Prurja maksimale 1400l/m

Presioni 150psi/ 10 bar

Me tubo me diametër deri në 76 mm

Komandim manual 180/ 360 grade

17.9 Hedhës shkumë cope 1

Gjatesia jo me shumë se 1.2 m

Diametër max. 76mm

Me mbajtëse me dizajnet për performancë me efikasë

17.1.1 Hedhëse profesionale Storz trup alumini

Ndërtimi prej trupi alumini siguron që grzka të jetë e lehtë dhe e qëndrueshme duke bërë me të lehtë për tu trajtuar gjatë operacioneve të shuarjes së zjarrit

Presioni Maksimal 360 psi

Madhësia e hyrjes 1.5 “ /2” 2.5 “

17.1.2 Tubo profesional për hedhje uji me bashkuese modeli storz

Tub Φ 72 4 x 30 ml

Tub Φ 52 4 x 25 ml

Tub Φ 45 4 x 25 ml

17.1.3 Prozhektor me stativ teleskopik portativ cope 2

17.1.4 Krik Binder per mundesimin e objekteve dhe makinave ne rast aksidentesh jo me pak se 2 T cope 3

17.1.5 Aparat oksigjeni AP3 2 cope te modelit profesional ne gjendje perfekte pune

18. TESTET DHE PRANIMI

Automjeti duhet të kalojë:

Testi	Kërkesa
Test pompë	2 orë në presion nominal
Test vakumi	Minimumi 60 sekonda pa humbje
Test tanku	Pa rrjedhje
Test funksional	Të gjitha sistemet operative

18. DOKUMENTACIONI

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatë CE;
- Certifikatë EN 1846;
- Certifikatë EN 1028;
- Manual teknik;
- Diagram elektrik/hidraulik;
- Test hidraulik pompe;
- Dokumentacion kolaudimi;
- Katalog teknik;
- Deklaratë konformiteti.

Në rast ekuivalence duhet të paraqitet dokumentacion krahasues teknik sipas nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020.

19. KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Automjeti duhet:

- Të jetë në gjendje të mirë teknike;
- Pa korrozion strukturor;
- Pa deformime shasie;
- Me pompë funksionale;
- Me pjesë rezervë të disponueshme;
- I gatshëm për operim emergjent 24/7.

-
- Automjeti duhet te gete garanci difektesh per nje periudhe 1 vit nga dita e dorezimit te Autoritetit Kontraktor si dhe operatori ekonomik duhet ti pergjigjet per riparim te difekteve brenda tre diteve nga marjja e njoftimit brenda periudhes se garancise .

➤ ***Defektet që mbulohen nga garancia***

- defekte motorike
- defekte të kutisë së shpejtësisë
- defekte të transmisionit
- defekte të paketave elektrike
- defekte të sistemit hidraulik.
- Defekt te pompes centrifugale

➤ ***Dokumentacioni ligjor në dorëzim:***

Automjeti duhet të dorëzohet me:

- Leje qarkullimi
- Targa
- Akt kolaudimi të vlefshëm në Shqipëri
- Certifikatë pronësie në emër të ofertuesit
- Siguracion të vlefshëm në ditën e dorëzimit
- Kalim pronësie nga ana e ofertuesit.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi i makinerisë	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Blerje automjet zjarrfikës	Copë	1		
	Shuma				
	T.v.sh		20%		
	Shuma TOTALE				

Afatet e lëvrimit:

NR	EMËRTIMI I MATERIALEVE	NJËSIA	SASIA	DITE
1	Blerje automjet zjarrfikës	lek	1	30

Afati i lëvrimit të mallit është 30(tridhjetë) dite nga data e nënshkrimit të kontratës .

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; (Ne vleren prej 2% te fondit limit te kontrates qe prokurohet)*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a) Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 teleshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2026 per secilin operator).

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘ ‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2026 per secilin operator).

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriteve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a)Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2023.2024.2025) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit te kontrates qe prokurohet dhe përkatësisht ne shumen prej 10'677'500(dhjetë milion e gjashtëqind e shtatedhjetë e shtate mije e peseqind) lekë pa tvsh.**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

b)-Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet financiare (2023,2024,2025), të certifikuara nga autoritetet përkatëse kompetente (Drejtorite Rajonale te Tatimeve) , që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet

Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse ne treguesit e bilanceve per dy vite te njepasnjeshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

Pervoje e sukseshme ne levrimin e furnizimin e mallrave si me poshte:

1.Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera/realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , me një vlerë jo me te vogel se 40 % e vlerës së përlloragatur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht jo me pak se vlera **4'271'000(katërmilion e dyqind e shtatedhjetë e nje mije) leke pa t.v.sh,** dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

3.1-a)-Operatori ekonomik duhet të deklarojë skeden teknike ose katalogun perkates të mjetit dhe me foto në menyre që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike kryesore të mjetit me parametrat teknike të kërkuara nga AK.

3.1.b-Ne momentin e dorëzimit mjeti duhet të jetë i lirë për të qarkulluar në territorin e Republikës së Shqipërisë (i zhdoganuar sipas legjislacionit doganor në fuqi dhe i lirë nga detyrimet perkatese fiskale), për të përmbushur këto pike ofertuesi duhet të paraqesë vetedeklarim perkates që për mallin e ofruar nuk ka detyrime fiskale/tatimore që rrjedhin nga dispozitat e legjislacionit perkates doganor e rrugor në Republikën e Shqipërisë .

3.2-c) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizojë/transportojë dhe të dorëzojë mallin objekt kontrate, në vendet e percaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK, brenda afatit të levrimit . (kjo pike në fazën e ofertimit plotësohet nepermjet nje Deklarate të leshuar nga Administratori i shoqërisë).

3.3-d).Operatori duhet të paraqesë nje **deklarate garancie për nje periudhe 1 vjecare /1500 ore pune,** nga data e marrjes në dorëzim të mjetit nepermjet se ciles ofertuesi mer persiper kryerjen e sherbimit riparimit e defekteve të mjetit të paparashikuar dhe zevendesimin e pjeseve të ndryshme të tij të demtuara gjate periudhes se garancise sipas specifikimeve teknike , me artikuj origjinal ose ekuivalente në standart me ato origjinal , në të cilën të jenë të percaktuar qarte të gjitha kushtet e garancise teknike të mjetit(kjo pike plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit të kandidatit ofertues).

4.)Operoret e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar "Apostille". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrtarë respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Shenim: Në zbatim të nenit 82.5 të Ligjit nr 162/2020 "Per Prokurimin Publik" dhe të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : "Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e

dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike⁶. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontratës, në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁷.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

